
	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 11</i>

24.04.2026

Komente ndaj Raportit Konsultativ të ZRrE për Përshtatjet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT për vitin 2026

Prill 2026

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 11</i>

HYRJE

KOSTT me 14 Prill 2026 ka pranuar Raportin e Publikuar nga ZRrE për Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT për vitin relevant tarifor 2026.

KOSTT në vazhdim paraqet komentet ndaj këtij raporti.

1. KOSTOT OPERATIVE

Sa i përket kostove operative KOSTT në vazhdim ka paraqitur komentet lidhur me koston e blerjes së humbjeve në transmetim, koston e shërbimeve ndihmëse dhe Shpenzimet tjera operative (OPEX).

1.1 Kosto e blerjeve të humbjeve në transmetim

Vlerësojmë se çmimet e parashikuara për energjinë e përdorur në mbulimin e humbjeve nga Prilli e tutje janë nënvlerësuar. Parashikimi mbështetet në mesatare mujore të tregut, të cilat nuk reflektojnë profilin real të blerjes për humbje (i përqendruar në orë me ngarkesë dhe çmime më të larta), si dhe nuk adreson në mënyrë të mjaftueshme kufizimet ndërkufitare që reduktojnë konkurrencën dhe rrisin çmimet në ALPEX. Për më tepër, zhvillimet e fundit gjeopolitike, përfshirë luftërat dhe krizat energjetike në rajon dhe më gjerë, kanë rritur ndjeshëm volatilitetin dhe pasigurinë në tregjet e energjisë, duke ushtruar presion shtesë në çmime. Çdo devijim nga disponueshmëria e energjisë me çmim të rregulluar (KEK) rrit më tej ekspozimin ndaj tregut. Si rezultat, ekziston një rrezik i konsiderueshëm që kostot reale të tejkalojnë nivelet e lejuara. KOSTT kërkon rishikimin e çmimit për blerjen e humbjeve përkitazi me gjendjen reale në treg.

1.2 Kostot e shërbimeve ndihmëse

ZRRE ka theksuar se niveli i shpenzimeve të realizuara për vitin 2025 përfaqëson një standard të arsyeshëm dhe efikas për vitin 2026, duke propozuar lejimin e kostove në vlerë prej 39.64 milionë €. Megjithatë, të dhënat e realizuara për tre muajt e parë të vitit 2026 tregojnë qartë se ky supozim nuk reflekton realitetin aktual të operimit të sistemit.

Në veçanti, zhvillimet në treg dhe kushtet operacionale gjatë këtij viti kanë rezultuar në devijime të konsiderueshme nga parashikimet, duke çuar në rritje të kostove të balancimit përtej niveleve të planifikuara. Kjo tregon se përdorimi i vitit 2025 si bazë referuese për vitin 2026 nuk është më i qëndrueshëm dhe nuk merr në konsideratë dinamikat aktuale të tregut dhe sfidat operacionale me të cilat përballlet sistemi.



Duke marrë parasysh këto zhvillime, konsiderojmë se qasja e propozuar nga Rregullatori nënvlerëson kostot reale të nevojshme për operimin e sigurt dhe efikas të sistemit dhe, si e tillë, duhet të rishikohet. Një vlerësim më realist duhet të bazohet në të dhënat aktuale të vitit 2026 dhe në trendet e fundit të tregut, në mënyrë që të shmangët krijimi i një hendeku financiar dhe rreziku për funksionimin e qëndrueshëm të sistemit.

Të dhënat e detajuara mbi realizimin, krahasuar me planifikimin për tre muajt e parë të vitit 2026, janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 1. Realizimi i shërbimeve ndihmëse tre muajt e parë 2026


Muaji	Planifikimi Janar -Mars 2026			Realizimi Janar -Mars 2026		
	aFRR	mFRR	Total	aFRR	mFRR	Total
Janar	2,938,056.00	962,259.84	3,900,315.84	2,986,705.51	913,466.70	3,900,172.21
Shkurt	2,653,728.00	876,529.92	3,530,257.92	2,999,056.58	853,797.36	3,852,853.94
Mars	2,938,056.00	1,001,379.36	3,939,435.36	3,389,211.67	949,983.74	4,339,195.41
Total Planifikimi KOSTT 2026			11,370,009.12	Total Realizimi KOSTT 2026		12,092,221.56

Siç shihet, për tre muajt e parë të këtij viti, kostot e realizuara tejkalojnë planifikimin për 722,212.14 €, përkatësisht me 6.35%.

1.3 Shpenzimet tjera operative (OPEX)

ZRRE, në Raportin Konsultativ për Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT, ka propozuar një nivel të shpenzimeve operative (OPEX) për KOSTT në vlerë prej 8,105,564.64 €. Ndërkohë, sipas të dhënave të realizuara, KOSTT gjatë vitit 2025 ka regjistruar shpenzime operative në vlerë prej 9,157,650.11 €, çka paraqet një diferencë të konsiderueshme ndërmjet nivelit të propozuar dhe atij faktik.

Në këtë kontekst, KOSTT kërkon nga ZRRE që të aprovojë shpenzimet operative në përputhje me nivelin e realizuar për vitin 2025, duke qenë se ky nivel pasqyron në mënyrë më reale dhe të verifikueshme kostot e domosdoshme për operimin e sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të sistemit elektroenergetik. Është me rëndësi të theksohet se periudha në fjalë karakterizohet nga presione të vazhdueshme inflacionare, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kostove të inpueteve kryesore, përfshirë energjinë, shërbimet, materialet dhe kostot e mirëmbajtjes. Për më tepër, tregu i punës në sektorin e energjisë po përballet me sfida të konsiderueshme në drejtim të ruajtjes dhe tërheqjes së stafit të

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 11</i>

kualifikuar, duke e bërë të domosdoshme rishikimin e niveleve të pagave dhe përfitimeve, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia dhe cilësia e operimit.

Rritja e kostove të personelit nuk duhet të shihet vetëm si një barrë financiare, por si një investim i domosdoshëm në kapitalin njerëzor, i cili është kritik për funksionimin e pandërprerë dhe të sigurt të sistemit të transmisionit. Mosreflektimi i këtyre kostove në nivelin e lejuar të të hyrave mund të rezultojë në vështirësi operative, ulje të motivimit të stafit dhe rritje të rrezikut për largimin e kuadrove profesionale.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se niveli i realizuar i shpenzimeve për vitin 2025 tashmë përfaqëson një standard të provuar dhe të auditueshëm, i cili merr parasysh kushtet reale të operimit dhe sfidat aktuale të tregut. Në këtë drejtim, përdorimi i një niveli më të ulët të OPEX-it, siç propozohet nga ZRRE, do të krijonte një hendek financiar të pajustificuar dhe do të cenonte aftësinë e KOSTT për të përmbushur detyrimet e saj ligjore dhe operacionale.

Në përfundim, KOSTT konsideron se aprovimi i shpenzimeve operative në përputhje me realizimin e vitit 2025 është i domosdoshëm për të siguruar stabilitet financiar, për të garantuar operim të sigurt dhe efikas të sistemit, si dhe për të përballuar në mënyrë adekuate zhvillimet e fundit ekonomike dhe tregtare. Rrjedhimisht, kërkohet që ZRRE të rishqyrtojë propozimin e saj dhe të reflektojë në mënyrë të plotë kostot reale dhe të arsyeshme të operimit.


2. SHPENZIMET KAPITALE

KOSTT vlerëson aprovimin e disa projekteve në këtë fazë, por thekson se nuk janë përfshirë të gjitha projektet që kanë rëndësi të madhe për zhvillimin dhe përmirësimin e rrjetit të transmetimit.

KOSTT vazhdon të mbajë të njëjtin qëndrim si në kërkesën e mëparshme lidhur me përfshirjen e projekteve të propozuara në këtë proces. Ky qëndrim është i qëndrueshëm dhe i bazuar në analizat teknike dhe strategjike që kemi paraqitur edhe më herët.

Lista e projekteve e aprovuar është si në vijim:

- NS Klina – Rehabilitimi i nënstacionit dhe instalimi i transformatorit të dytë TR2 110/10(20) kV, 40 MVA
- NS Gjilani 5 – Instalimi i transformatorit të dytë TR2 110/10(20) kV, 40 MVA
- NS Gjakova 1 – Zëvendësimi i transformatorit TR2 110/35/20 kV, 40 MVA
- NS Gjilani 1 – Zëvendësimi i transformatorit TR2 110/35/10(20) kV, 40 MVA
- NS Prizreni 1 dhe NS Viti – Zëvendësimi i transformatorëve përkatës
- NS Vitia – Zëvendësimi i transformatorit TR1 110/35/10(20)/35 kV, 40 MVA

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 11</i>

- NS Prizreni 3 – Zëvendësimi i transformatorit TR1
- Linja e re kabllore 110 kV NS Prizreni 1 – NS Prizreni 2
- Revitalizimi i linjës 110 kV NS Prizreni 1 – NS Prizreni 3
- NS Vushtrri 1 – Rekonstrukcioni i fushave 110 kV dhe pajisjeve përcjellëse
- NS Burimi – Rehabilitimi i nënstacionit
- NS Prishtina 1 – Zëvendësimi i transformatorit TR2
- NS Skenderaj dhe NS Gjakova 2 – Zëvendësimi i transformatorëve përkatës


Megjithatë, vlen të theksohet se Projekti **NS Vallaq: rekonstruimi i fushave 110 kV (5 fusha të linjave + 2 fusha të transformatorëve + fusha lidhëse, zbarrat e dyfishta, furnizimet vetanake)** nuk është përfshirë në listën e projekteve të aprovuara, ndonëse i njëjti është pjesë e Planit Zhvillimor 10-vjeçar të transmetimit dhe ka qenë i përkrahur më herët nga ZRRë.

Në këtë kontekst, KOSTT thekson me prioritet të lartë rëndësinë e përfshirjes së këtij projekti dhe paraqet kërkesë që ai të aprovohet sa më parë, në mënyrë që të mundësohet fillimi i menjëhershëm i procedurave përkatëse. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se projekti planifikohet të financohet në kuadër të paketës së projekteve me BERZH, dhe çdo vonesë në aprovimin e tij mund të ndikojë drejtpërdrejt në realizimin në kohë dhe në sigurimin e financimit.

NS Vallaqi është një ndër nënstacionet më të hershme të ndërtuara në Kosovë, dhe si i tillë paraqet një nyje të rëndësishme të rrjetit të transmetimit. Rivitalizimi i këtij nënstacioni është i domosdoshëm, duke pasur parasysh se në zbarrat e tij 110 kV janë të lidhura pesë linja të tensionit 110 kV, përfshirë edhe linjën që bart fuqinë e gjeneruar nga HC Ujmani. Gjendja aktuale teknike e nënstacionit nuk është në nivel të kënaqshëm dhe paraqet rrezik për sigurinë operationale dhe besueshmërinë e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët.

Projekti i rivitalizimit parasheh modernizim të plotë të infrastrukturës, përfshirë zëvendësimin e pajisjeve të tensionit të lartë 110 kV, rindërtimin e sistemit të zbarrave dhe portaleve, si dhe kalimin në një konfigurim me zbarra të dyfishta dhe fushë lidhëse, që mundëson fleksibilitet dhe siguri më të lartë në operim.

- Përfitimet e pritshme nga realizimi i këtij projekti janë:
- Ngritja e sigurisë dhe besueshmërisë së operimit të nënstacionit
- Optimizimi i operimit pas kalimit në sistemin me zbarra të dyfishta
- Reduktimi i energjisë së padërguar te konsumatori
- Rritja e sigurisë për personelin operues dhe atë të mirëmbajtjes

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 6 nga 11</i>

Duke marrë parasysh të gjitha këto, përfshirja dhe aprovimi sa më i shpejtë i këtij projekti mbetet me rëndësi kritike për funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të sistemit elektroenergetik.

ZRrE nuk ka aprovuar edhe disa projektet tjera, të cilat KOSTT i konsideron me rëndësi të veçantë për sigurinë dhe zhvillimin e sistemit elektroenergetik.

Rindërtimi i linjës kabllore 6.3 kV NS Kosova B – TC Kosova B - NS Kosova B përbën një nga nyjet më kritike dhe me rëndësi jetike për funksionimin e sistemit elektroenergetik të Kosovës. Në këtë nënstacion janë të lidhur drejtpërdrejt dy gjeneratorët kryesorë të TC Kosova B (B1 dhe B2), si dhe linja të rëndësishme interkonektive. Për këtë arsye, çdo ndërprerje apo pasiguri në furnizim paraqet rrezik serioz për stabilitetin e gjithë sistemit elektroenergetik të vendit.


Konfigurimi fillestar ka qenë i bazuar në dy burime të pavarura 6.3 kV, por linja nga TC Kosova A tashmë është jashtë standardeve të besueshmërisë për shkak të degradimit të thellë teknik dhe mungesës së rehabilitimit. Si rezultat, nënstacioni ka mbetur pothuajse i varur nga një burim i vetëm – linja kabllore nga TC Kosova B, e cila që nga korriku 2025 ka pësuar defekte të përsëritura dhe konsiderohet e paqëndrueshme për operim të sigurt.

Aktualisht, furnizimi mbështetet në gjenerator dizel dhe lidhje emergjente nga rrjeti i KEDS, të cilat nuk përbëjnë zgjidhje të qëndrueshme dhe paraqesin rrezik të lartë dështimi. Kjo situatë është jashtë çdo standardi të pranueshëm operativ dhe paraqet rrezik të menjëhershëm për ndërprerje të plotë të furnizimit, me pasoja direkte në prodhimin nga TC Kosova B dhe stabilitetin e sistemit.

Në këtë kontekst, ndërtimi i linjës së re kabllore 6.3 kV nuk është më investim zhvillimor, por domosdoshmëri emergjente. Vlera e projektit është minimale në raport me rrezikun që eliminohet, ndërsa çdo vonesë rrit ndjeshëm probabilitetin e një krize energjetike me pasoja të rënda. Për këtë arsye, kërkohet trajtim me prioritet absolut.

Furnizimi me dy nënstacione mobile - Në vitet e fundit, sistemi elektroenergetik i Republikës së Kosovës po përballlet me një rritje të vazhdueshme dhe strukturore të kërkesës për energji elektrike, e cila tashmë paraqet një trend afatgjatë. Kjo rritje lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik, zgjerimin e sektorit privat, rritjen e konsumit familjar dhe elektrifikimin progresiv të sektorëve të ndryshëm. Si rrjedhojë, rrjeti ekzistues po operon gjithnjë e më shpesh në kushte të ngarkesave të larta, duke e reduktuar marginën e sigurisë operative.

Në këtë kontekst, nënstacionet e nivelit 110/35/10(20) kV përbëjnë pika kritike të sistemit, ku çdo dështim teknik mund të shkaktojë ndërprerje të gjera të furnizimit dhe pasoja të konsiderueshme ekonomike dhe sociale. Mungesa e kapaciteteve rezervë, veçanërisht e transformatorëve të fuqisë, e rrit ndjeshëm ekspozimin e sistemit ndaj rreziqeve operative.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 11</i>

Duhet theksuar se koha e zëvendësimit të një transformatori të fuqisë në kushte normale është shumë e gjatë (zakonisht 6–18 muaj), për shkak të proceseve të prodhimit, transportit dhe instalimit. Në mungesë të një zgjidhjeje alternative, kjo do të rezultonte në ndërprerje të zgjatura të furnizimit për zona të tëra, me ndikim të drejtpërdrejtë në industri, shërbime publike dhe mirëqenien e qytetarëve.

Në këtë prizëm, furnizimi me një nënstacion mobil duhet të trajtohet si një masë e domosdoshme parandaluese dhe strategjike për mbrojtjen e sistemit elektroenergjetik. Ky aset përfaqëson praktikë standarde në sistemet moderne, si pjesë e planeve të sigurisë dhe vazhdimësisë së operimit.

Përfitimet kryesore të këtij projekti përfshijnë:


- Reduktimin e kohës së reagimit në rast avarie, nga muaj në ditë ose javë
- Shmangien e ndërprerjeve të gjata përmes sigurimit të furnizimit të përkohshëm
- Rritjen e fleksibilitetit operativ dhe mundësinë e rikonfigurimit të rrjetit
- Mbështetjen e mirëmbajtjes së planifikuar pa ndërprerje të furnizimit
- Menaxhimin më efikas të ngarkesave sezonale dhe emergjente
- Rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit ndaj ngjarjeve të paparashikuara

Nga aspekti ekonomik, investimi prej rreth 3,000,000.00 euro është i arsyeshëm në raport me kostot potenciale të një ndërprerjeje të zgjatur të energjisë elektrike, të cilat mund të jenë shumëfish më të larta. Për këtë arsye, ky projekt duhet të konsiderohet si një sigurim strategjik ndaj rreziqeve me impakt të lartë.

Në përfundim, mungesa e një nënstacioni mobil paraqet një boshllëk të dukshëm në sigurinë e sistemit elektroenergjetik të Kosovës. Realizimi i këtij projekti është një hap i domosdoshëm drejt garantimit të sigurisë energjetike, stabilitetit ekonomik dhe funksionimit të qëndrueshëm të infrastrukturës kritike të vendit.

Në listën e projekteve nuk është përfshirë as projekti:

Zbatimi i Sistemit të Menaxhimit të Tregut të Energjisë Elektrike (EMMS) - i cili paraqet një hap strategjik dhe të domosdoshëm për modernizimin e sektorit energjetik në Kosovë, si dhe për zhvillimin e një tregu transparent, efikas dhe konkurrues të energjisë elektrike. Ky projekt mbështet drejtpërdrejt objektivat e KOSTT-it në rolin e tij si Operator i Sistemit të Transmetimit dhe Operator i Tregut, dhe njëkohësisht është në përputhje me prioritetet e BERZH-it për përshpejtimin e tranzicionit digjital dhe zvogëlimin e hendekut digjital në ekonominë ku investon.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 8 nga 11</i>

Aktualisht, operimi i tregut të energjisë elektrike dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet palëve të interesit mbështeten kryesisht në procese manuale, si përdorimi i Excel-it dhe komunikimi përmes email-it. Këto praktika krijojnë joefikasitet operacional, rrisin rrezikun e gabimeve dhe vonesave, si dhe kufizojnë ndjeshëm mundësinë për analiza të avancuara dhe vendimmarrje strategjike. Si rezultat, menaxhmenti shpesh përballlet me të dhëna të fragmentuara dhe të papërpunuara, të cilat nuk mbështesin vendime të mirëinformuara dhe të orientuara drejt zhvillimit afatgjatë të tregut.


Në kontekstin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, nevoja për një platformë të integruar digjitale bëhet edhe më kritike. EMMS do të shërbejë si një shtyllë kyçe për funksionimin e tregut të liberalizuar, duke mundësuar automatizimin dhe centralizimin e proceseve të mbledhjes, validimit, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave të tregut. Kjo do të sigurojë qasje të barabartë, të besueshme dhe në kohë reale në informacione relevante për të gjithë pjesëmarrësit e tregut, përfshirë prodhuesit, furnizuesit, tregtarët, operatorët e ruajtjes, operatorin e shpërndarjes dhe rregullatorin.

Përmes EMMS, KOSTT do të ketë mundësi të avancuara për monitorim në kohë reale të aktiviteteve të tregut, përdorimin e paneleve të kontrollit (dashboards) me tregues kyç të performancës (KPI), si dhe analiza të detajuara të trendeve të tregut. Kjo do të rrisë ndjeshëm transparencën dhe parashikueshmërinë, do të forcojë konkurrencën dhe do të kontribuojë në stabilitetin e përgjithshëm të tregut. Njëkohësisht, sistemi do të integrojë kërkesat rregullative dhe rregullat e tregut, duke mundësuar mbikëqyrje më efektive, raportim të automatizuar dhe nivel më të lartë llogaridhënieje ndaj ZRrE-së.

Përfitimet e projektit shtrihen përtej aspektit teknologjik. EMMS do të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe në zhvillimin e një kulture vendimmarrjeje të bazuar në të dhëna dhe analiza të mirëfillta. Përmes trajnimeve të specializuara dhe zhvillimit profesional, stafi do të orientohet drejt detyrave më analitike dhe strategjike, duke rritur efikasitetin organizativ, cilësinë e vendimmarrjes dhe aftësinë për planifikim dhe parashikim afatgjatë.

Në përfundim, duke marrë parasysh rolin rajonal të KOSTT-it dhe ndërlidhjen e sistemit të transmetimit me vendet fqinje, EMMS duhet të projektohet në mënyrë që të mbështesë ndërveprimin rajonal dhe integrimin gradual në tregun e përbashkët të energjisë elektrike të Bashkimit Evropian. Ky projekt do të vendosë themele të qëndrueshme për një treg modern, transparent dhe të integruar, duke kontribuar në rritjen ekonomike, sigurinë energjetike dhe zhvillimin afatgjatë të Kosovës.

Siç është theksuar në dokumentacionin paraprak, projektet në fjalë përbëjnë një komponent thelbësor për zhvillimin afatgjatë dhe modernizimin e rrjetit të transmetimit. Ato kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve transmetuese, përmirësimin e stabilitetit të sistemit dhe menaxhimin më efikas të ngarkesës. Për më tepër, realizimi i tyre do të ndikojë në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 9 nga 11</i>

elektrike, duke reduktuar ndërprerjet dhe humbjet teknike, si dhe duke garantuar një shërbim më cilësor dhe më të besueshëm për konsumatorët.

Kërkesë për projekt të ri: NS Shtime 110/35/10(20) kV

Gjithashtu, KOSTT paraqet kërkesë për përfshirjen dhe aprovimin e projektit të ri NS Shtime 110/35/10(20) kV, i cili vlerësohet si i domosdoshëm për garantimin e sigurisë së furnizimit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rrjetit në këtë zonë.

Komuna e Shtimes karakterizohet nga një rritje graduale e kërkesës për energji elektrike, ku në tri vitet e fundit është vërejtur një trend dukshëm më i lartë krahasuar me periudhat paraprake. Aktualisht, konsumatorët e Komunës së Shtimes furnizohen nga nënstacioni NS Shtime 35/10 kV, i cili ka të instaluar tre transformatorë me kapacitet nominal 2x8 MVA + 4 MVA. Ky nënstacion furnizohet nga NS Lipjani 110/35/10 kV përmes linjës 35 kV me seksion tërthor 120 mm² dhe kapacitet nominal 404 A, respektivisht 24.5 MVA.

Rritja e kërkesës në NS Shtime po ndikon në cenimin e sigurisë së furnizimit në këtë komunë, si pasojë e afrimit të kufijve të kapacitetit bartës të linjës së vetme furnizuese 35 kV NS Shtime – NS Lipjan gjatë periudhave të ngarkesave maksimale. Për më tepër, rreziku i mosfurnizimit rritet edhe për shkak të konfigurimit radial të furnizimit të Shtimes.


Nga ana tjetër, edhe në NS Lipjan niveli i ngarkimit të dy transformatorëve 110/35 kV është afër kufirit të ngopjes, pasi përmes tyre bartet i gjithë konsumi i NS Shtime, si dhe ngarkesat e Magurës dhe së fundmi edhe të Qendrës tregtare “Prishtina Mall”. Si rezultat, NS Lipjani renditet ndër nënstacionet me ngarkesë relativisht të lartë krahasuar me shumicën e nënstacioneve tjera të sistemit.

Për këto arsye, KEDS ka paraqitur kërkesë (aplikim për kyçje) në KOSTT për ndërtimin e nënstacionit të ri NS Shtime 110/35/10(20) kV. Duke marrë parasysh kapacitetin relativisht të lartë të linjës ekzistuese 35 kV, është kërkuar që nënstacioni të projektohet me dy nivele të tensionit distributiv: 35 kV dhe 10(20) kV. Kjo zgjidhje mundëson ruajtjen e kapacitetit rezervë prej rreth 24 MW ndërmjet NS Lipjan dhe NS Shtime. Në këtë kuadër, transformatori i parë është paraparë të jetë tre-pështjellor 110/35/10(20) kV me kapacitet 40 MVA.

Figura 1. Shtrirja gjeografike e projektit NS Shtime 110/35/10(20) kV




Figura 2. Skema njëpolare kyçjes së NS Shtime në Rrjetin Transmetues



Përfitimet e pritshme nga ky projekt janë:

- Furnizimi i besueshëm dhe kualitativ i konsumit të Shtimes
- Optimizimi i rrjedhave të fuqisë dhe shkarkimi i transformatorëve ne NS Lipjan
- Reduktimi i sasive të mëdha të energjisë së padërguar te konsumatori si rrjedhojë e eliminimit të fytëve të ngushta ne rrjetin e shpërndarjes
- Reduktimi i humbjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes
- Krijimi i kushteve për integrim të BRE-ve

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 11</i>

- Përkrahje e zhvillimit ekonomik të Shtimes

Projekti është planifikuar të përfundoj në vitin 2029. Në Planin Zhvillimor të Transmetimit figuron projekti NS Shtime, për të cilin afati i realizimit është rishikuar dhe është zhvendosur nga viti 2034 në vitin 2029. Për këtë ndryshim, ZRrE është informuar dhe njoftuar zyrtarisht në kuadër të takimit konsultativ të zhvilluar gjatë vitit të kaluar.

Për KOSTT, përfshirja e këtyre projekteve në këtë fazë është me rëndësi të veçantë, duke marrë parasysh ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë në përmirësimin e performancës së sistemit elektroenergjetik dhe në avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit energjetik në vend.

Në këtë kontekst, i bëjmë thirrje ZRrE-së që të rishqyrtojë me kujdes propozimin e paraqitur në Raportin Konsultativ dhe të marrë në konsideratë argumentet dhe dokumentacionin e ofruar nga KOSTT, me qëllim aprovimin e projekteve të propozuara.

PËRMBYLLJE

KOSTT shpreh besimin dhe pritjen që kërkesat e paraqitura do të shqyrtohen dhe aprovohen nga ZRRE, duke marrë parasysh prioritetet strategjike, tendencat drejt normalizimit të sektorit energjetik dhe rrethanat e reja të krijuara në tregun e energjisë.

Në këtë kontekst, vlerësohet thelbësore që niveli i OPEX-it të reflektojë në mënyrë reale kostot e nevojshme për operimin e sigurt dhe efikas të sistemit, përfshirë nevojën për mirëmbajtje të qëndrueshme, përballimin e presioneve inflacionare dhe sigurimin e kushteve konkurruese për kapitalin njerëzor. Një qasje e tillë kontribuon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë financiare dhe operacionale të operatorit të sistemit të transmisionit.

Gjithashtu, theksohet rëndësia e stabilizimit të çmimeve të energjisë, forcimit të sigurisë kombëtare dhe energjetike, si dhe orientimit të investimeve drejt projekteve me ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë e sistemit.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, nënvizohen përfitimet që këto investime sjellin për qytetarët si përfitues fundorë, në formë të furnizimit më të sigurt, më të qëndrueshëm dhe më cilësor me energji elektrike.